

DENIS HIMÇI & AMARDA HIMÇI

**PRURJET NGA DIALEKTET SI BURIM I PASURIMIT DHE FRESKISË
SË GJUHËS SHQIPE**

(Mbështetur edhe në të dhënat e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe (ADGJSH))

Në kumtesën tonë, duke u nisur nga tema, duket sikur kemi të bëjmë me një analizë të dialekteve apo gjuhës shqipe standarde. Shumë diskutime apo kumtesa janë bërë e mbajtur në lidhje me vlerat e dialekteve si dhe për arritjet e formimit të gjuhës standarde. Është e vërtetë që është folur e shkruar për çështje të tilla thelbësore për gjuhësinë shqiptare, por hera-herës nuk kanë karakter linguistik, e aq më pak kanë lidhje me pasurinë dialektore të gjuhës shqipe, si burim për standardin. Para se të sjellim një pasqyrë të prurjeve dialektore në standardin e shqipes së sotme mund të bëjmë diçka në lidhje me gjuhën shqipe. Çështja e standardit dhe e raportit të tij me dialektet është bërë objekt diskutimesh e debatesh në konferenca të ndryshme e deri në shtypin e shkruar e atë viziv qysh prej Kongresit të Drejtshkrimit¹.

Por nuk është ky, qëllimi ynë në këtë kumtesë. Në qendër të analizës sonë është se ç'ndodh me prurjet e dialekteve në shqipen standarde, ku kanë gjetur atë pasqyrim në dokumentet e shqipes, sidomos në kohën e ndryshimeve të mëdha demografike e shoqërore që kanë ndodhur në kushtet e sotme, të cilat lidhen edhe me vetë gjeopolitikën e vendit. Lëvizja e njerëzve lirisht brenda dhe jashtë vendit do të shoqërohet edhe me lëvizjen e gjuhës, e cila bashkë me përdoruesit e saj del nga enklavat territoriale për t'u ballafaquar me "tregun" gjuhësor kombëtar². Në këto kushte konceptet "*të folme*", "*dialekt*", etj. po humbin vlerën e tyre teorike klasike dhe gjuha shqipe nën efektet e shoqërisë globale e të sipërmarrjes së lirë, po ballafaqohet me dukuri të reja siç janë: sociolektet apo të folme të grupimeve të ndryshme a njëloj "përzierje dialektore" etj.³. Nga ana tjetër prof. Gjovalin Shkurtaj thekson: "Dialektet dhe gjuha standarde, si variant i ngritur mbi bazën e një dialekti nuk janë dy ushtri kundërshtarë që ndeshen për jetë a vdekje dhe njëra shfaros tjetrën, por janë degëzime e bija të së njëjtës gjuhë, lindin dhe zhvillohen në të njëjtën bashkësi shoqërore"⁴. Nga ana tjetër standardi duhet të pranojë në mënyrë të natyrshme prurje të gjithanshme nga e gjithë gjuha, qofshin ato brenda e jashtë trevave shqiptare. Por, duke u kushtuar vëmendje prirjes dhe përvijimit të gjuhës letrare standarde, sikur po zbehet rëndësia e dialekteve e aq më tepër

¹ Kongresi i Drejtshkrimit, I, II, Tiranë, 1972.

² Sh. Rrokaj, *Roli i dialekteve në shtrirjen dhe zgjerimin e standardit*, "Kumtesat", "Java e shkencës", Prishtinë, 2012, f. 26.

³ Po aty.

⁴ Gj. Shkurtaj, *Kahe dhe dukuri të kulturës dhe gjuhës shqipe*, 2003, f. 57.

ekzistenca e rëndësisë së dialektit bazë në trajtesat e sotme. Dijetari frëng Sharl Nodie midis të tjerave ka theksuar:

“Ai njeri që nuk ka hulumtuar me kujdes dialektet dhe të folmet e gjuhës së vet nuk njeh as gjysmën e saj”.⁵

Megjithatë ne jemi dëshmitarë të atij zhvillimi historik të sotëm ku të folmet popullore apo përgjithësisht i dialekteve shqiptare nuk mund të shihet i shkëputur nga rrjedhat e zhvillimit dhe kaheve të përgjithshme kulturore dhe mendore të bashkësisë shoqërore shqiptare, shtetërore e më gjerë. Një pasqyrë e gjallë e kësaj përshtatjeje është gjuha shqipe dhe dialektet. Dialektet në çdo gjuhë të botës, kanë shërbyer e vlejnë kurdoherë si gurra të pasurimit e të larmisë shprehëse të gjuhëve të njësuar⁶.

Duke qenë aspekte të një realiteti të gjallë gjuhësor në to ruhen të dhëna historike të njësive gjuhësore, gjurmë të gjalla që tregojnë ekzistencën dhe vjetërsinë e një gjuhe që përfaqëson një komb, gjuha shqipe-kombin shqiptar. Dialektologët janë përpjekur të përcaktojnë gjeografikisht kufijtë hapësinorë të dukurive gjuhësore dhe këto dukuri me kufij të prerë e të qartë i përkasin dukurive fonetike e morfologjike. Ndërsa përta i përket dukurive leksikore e frazeologjike, në dialektologjinë shqiptare studimet kanë qenë më të pakta ose pjesërisht të studiuar. Një pasqyrë më të gjerë dhe reale lidhur me dallimin leksikor të të folmeve të shqipes e jep Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (ADGJSH), me hartat përkatëse ku dallimi i vërtetë përbëhet nga fjalë, kuptime, frazeologjizma, togje të lira e të qëndrueshme. Këtu duhet të kemi parasysh se nuk kemi të bëjmë me fjalë që ndryshe thuhet në gegërisht e ndryshe në toskërisht, pra me fjalë që i përkasin kuptimeve të ndryshme, sepse atëherë do të kishim të bënim me gjuhë të ndryshme e jo me dialekte. Hartimi i “Atlasi dialektologjik të gjuhës shqipe” i përket fazës së dytë, të etapës së dytë të dialektologjisë shqiptare.

Kohët e fundit, kërkimet dialektologjike, sikur kanë rënë dhe nuk e kanë më atë zhvillim të disa viteve më parë, përveç se shtimit të botimeve dhe ndihmesave dialektologjike në trojet shqiptare të Kosovës e të Maqedonisë. Botimi dyvëllimësh i ADGJSH-së, fryt i një pune shumëvjeçare e të kujdesshme është një nga botimet që do t’u vijë në ndihmë të gjithë studiuesve, shkollarëve e gjithë brezit të gjuhëtarëve brenda e jashtë Shqipërisë.

Pas botimeve të veprave gjuhësore me vlerë kombëtare për gjuhën shqipe siç ishte: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Fonetika dhe gramatika e gjuhës shqipe, Fjalori i gjuhës shqipe*, vjen si vepër madhore, si një prurje e arritshme nga një punë shumëvjeçare e studiuesve, gjuhëtarëve e dialektologëve shqiptarë Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe.

Botimi i këtij atlasi do të ishte për gjuhësinë shqiptare një nga dëshmitë më me vlerë në zhvillimin e shkencës shqiptare. Lënda gjuhësore e trajtuar në “Atlas”

⁵ J. Gjinari, Gj. Shkurta, *Dialektologjia*, Ribotim, Tiranë, 2003.

⁶ Gj. Shkurta, *Pasuria leksikore e gegërishtes dhe gjuha e njësuar*. Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore “Gjuha standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.

Prurjet nga dialektet si burim i pasurimit dhe freskisë së gjuhës shqipe

është parë në lidhje me sistemin gjuhësor (fonologjik, morfologjik e leksikor) në lidhje dialektike me vendin që kanë në strukturën fonetike e gramatikore dhe në lidhje me funksionin që luajnë në gjuhë veçoritë dalluese dialektore, p.sh. tingujt janë parë si njësi të inventarit të fonemave dhe si variante etimologjike të tyre, d.m.th. si dallime dialektore në përbërjen e fonemave të fjalëve; po ashtu edhe dallimet dialektore morfologjike janë parë të lidhura me strukturën, d.m.th. me inventarin e kategorive të ndryshme gramatikore, me variantet e strukturave të formave gramatikore, me dendurinë e përdorimit të varianteve dialektore në një areal, së fundi, me ndryshueshmërinë fonetike, në të cilën paraqitet një formë gramatikore në areale të ndryshme dialektore⁷...

Studimi i dialekteve në një atlas dialektologjik ka karakter krahasimor, baza e krahasimit për studimin e dialekteve është bërë në lidhje me *gjuhën letrare kombëtare*. ADGJSH-ja na jep një panoramë të gjendjes së dialekteve të shqipes në prerjen e sotme kohore, pasi nuk ekziston dhe nuk njohim një stad të hershëm zhvillimi të gjuhës shqipe, ku të analizohen të gjitha veçoritë e tipareve gjuhësore në të gjitha sistemet e nënsistemet e saj.

Por, mos të ndalemi në hollësitë e ndërtimit të kësaj vepre, pasi në këtë kumtesë të shkurtër nuk mund të lëmë pa analizuar rëndësinë e botimit të ADGJSH-së. Duke iu referuar gjithmonë këtij botimi, nuk është se po citojmë ndonjë të re në lidhje me vlerësimet që i kanë bërë më parë studiuesit tanë.

Duke qenë një atlas i përgjithshëm e jokrahinor, ai pasqyron të folmet e shqipes me të njëjtat dukuri gjuhësore, prandaj ai është vetëm gjuhësor dhe dialektologjik pasi pasqyron dialektet territoriale të gjuhës shqipe. Përmes pyetësorëve të ndryshëm, realizuar nga specialistë dhe dialektologë të njohur: (J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani, B. Beci, M. Tafani e A. Dodi) u arritën mjaft të dhëna dialektore në pjesën e fonetikës, në pjesën e gramatikës si dhe në fushën e leksikut. Pra, mbi bazën e pyetësorëve dhe anketave specialistët ndienin përgjegjësinë përballë kësaj pune madhore për saktësinë dhe ekzakhtësinë me përpikmëri të izoglosave në “atlas” të të dhënave gjuhësore. Pra, botimi i ADGJSH-së nuk qe fryt i një pune brenda një viti apo disa viteve, ai është rezultat i një projekti bashkëpunimi shumëvjeçar me të dhëna shkencore e ekzakthe të studiuara në terren e jo në tryezat e laboratorëve.

Vlerat e botimit të ADGJSH-së janë të pallogaritshme sepse:

- Në të pasqyrohet me qartësi gjuha shqipe në tërë territorin ku flitet, brenda kufijve të Shqipërisë e jashtë saj.
- Pasqyrohen dialektet, në kushtet e sotme të zhvillimit gjuhësor në përputhje me zhvillimin e vendit dhe përparësitë në të gjitha fushat e studimit të shkencës, shkallën dalluese midis tyre etj.
- Përmes hartave të ADGJSH-së pasqyrohen ndryshimet, gjithashtu shpjegimi i shkaqeve të këtyre ndryshimeve të brendshme gjuhësore, në krahina e

⁷ ADGJSH, *Vështrime mbi dialektologjinë shqiptare*, vëll. I, 2007, f. 15.

zona të ndryshme territoriale nga njëra anë, si dhe për të shpjeguar e kuptuar se si është formuar dhe zhvilluar më tej gjuha letrare standarde.

Atlasi ynë, si dhe shumë atlase të tjerë dialektologjikë të vendeve të tjera, si në Francë, Gjermani etj., dallohet për saktësinë e izoglosave. Përpos të gjithave, dialektologët me punën e tyre janë përpjekur të caktojnë edhe kufijtë e shtrirjes së dukurive gjuhësore, edhe për të dhënë një pasqyrë të plotë të ndryshimeve të këtyre dukurive si, dukuritë fonetike dhe morfologjike ku kufijtë janë më të qartë. P.sh. ã-ja hundore e gegërishtes dhe ë-ja e theksuar në toskërishte, si gjegjësjë e saj e ardhur pikërisht nga një evolucion historik: *ã në ë: nãna-nëna; i rãndë-i rëndë; kãmbë-këmbë; ose -ruajtja e n-së ndërzanore në gegërishte dhe kalimi i saj në r-n në toskërishte; ruajtja e o-së në grupin vo-n në gegërishte (i vokët; voj; voa) etj. dhe kalimi në i kësaj zanoreje në -a-n toskërishte etj.*⁸

Përsa i përket studimeve në leksikun dialektor kanë qenë më të pakta. Megjithatë hartat e ADGJSH-së japin një pasqyrë dalluese për fushën e leksikut të të folmeve të shqipes. Në qoftë se do t'i referohemi edhe një herë J. Gjinarit, në librin "Dialektologjia" në pjesën për leksikun shkëpusim:

"Në sferën e leksikut janë shumë të pakta në numër fjalët që dallojnë plotësisht njërin dialekt nga tjetri: çel, çelës, çerdhe, dryn, fik (zjarrin), ftyr ose ftyrë, herët, katun "katund", krejt, mrrij, "mbërrij"... etj.

Toskërishtja këtyre u përgjigjet plotësisht me këto fjalë:

*"hap, kyc, fole, kyç ose katarin, shuaj, surrat ose faqe, shpejt, fshat, fare, arrij etj..."*⁹

Ekzistenca e këtyre dysorëve nuk tregon se kemi të bëjmë me kufij të prerë apo me ndarje të plota, pasi kemi fjalë që përdoren si në toskërishte edhe në gegërishte (*hap-çel-* në gegërishte) por edhe në gegërishte përdoret fjala *hap-krahas çel*.

Në qoftë se do t'i referohemi prof. Gj. Shkurtaç në një kumtesë "*Elemente etnokulturore në fjalorë të shqipes*" Tiranë¹⁰, midis të tjerave thekson:

...përhapja e fjalëve krahinore dhe dialektore që dallon e diferencon dialektet e të folmet e shqipes është shumë më e ndërlikuar dhe nuk mund të paraqitet me ndarje a kufij të prerë; aq më e vlefshme është kjo për frazeologjinë dhe fjalët me përmbajtje të theksuar etnokulturore, ku shtrirja gjeografike është më shumë fryt i arealeve mendësore e etnologjike se sa mirëfilli dialektore...

...dallimi i vërtetë përbëhet nga fjalë, kuptime, frazeologjizma, togje të lira a të qëndrueshme, mënyra të thëni që janë karakteristike për zona më të gjera, herë më të ngushta të gegërishtes, por që mungojnë tërësisht (ose pjesërisht) në krahinat e toskërishtes (anasjelltas).

Në ADGJSH nuk janë hetuar dhe nuk trajtohen fjalët me kuptime e përdorime të përbashkëta. Fjalët e tjera, ato që dallojnë të folmet në sferën e leksikut, janë dy

⁸ J. Gjinari, *Dialektet e shqipes*, Tiranë, 1989.

⁹ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 1997, f. 179.

¹⁰ Gj. Shkurtaç, *Elemente etnokulturore në fjalorë të shqipes*, "Kundërime Gjuhësore", Tiranë, Dhjetor 2004, f. 117.

Prurjet nga dialektet si burim i pasurimit dhe freskisë së gjuhës shqipe

llojesh për nga karakteri dialektor i tyre. Gjithmonë duke iu referuar ADGJSH-së ka fjalë dialektore që ekzistojnë dhe mungojnë fare përgjegjëset e tyre në zona të tjera. Fjalë të tilla lidhen me veçoritë natyrore, ekonomike dhe etnografike të zonës. Janë të rëndësishme vetëm për karakterizimin e të folmeve të veçanta¹¹.

Në grupin e dytë përfshihen fjalë të ndryshme dialektore që emërtojnë të njëjtin send ose dukuri, p.sh. *gjel: kokosh: kaposh: këndez* etj.

ADGJSH ka përfshirë një pjesë të këtyre fjalëve dhe në zgjedhjen e tyre është nisur në radhë të parë nga interesi për historinë e gjuhës dhe për gjuhën e sotme letrare.

Me gjithë rëndësinë dhe vlerat e studimit të kësaj vepre, ky atlas do të ndiqet nga atlase të tjerë krahinorë që do të hartohen në etapa të ardhshme për njohjen më me hollësi dhe më me thellësi të tipareve dhe çështjeve të veçanta që kanë njësitë e ndryshme dialektore të shqipes, si vlera dhe prurje mirëfilli gjuhësore për mbajtjen gjallë të gjuhës shqipe.

BIBLIOGRAFI

ADGJSH, *Vështrime mbi dialektologjinë shqiptare*, vëll. I, 2007.

Gj. Shkurtaj, *Elemente etnokulturore në fjalorë të shqipes*, “Kundrime Gjuhësore”, Tiranë, Dhjetor 2004.

Kongresi i Drejtshkrimit, I, II, Tiranë 1972.

Gj. Shkurtaj, *Kahe dhe dukuri të kulturës dhe gjuhës shqipe*, Tiranë 2003.

Gj. Shkurtaj, *Pasuria leksikore e gegërishtes dhe gjuha e njësuar*. Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore “Gjuha standarde dhe shoqëria shqiptare sot” Akademia e Shkencave, Tiranë 2002.

J. Gjinari, *Dialektet e shqipes*, Tiranë, 1989.

J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 1997.

J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, Ribotim, Tiranë, 2003.

Sh. Rrokaj, *Roli i dialekteve në shtrirjen dhe zgjerimin e standardit*, “Kumtesat”, “Java e shkencës”, Prishtinë, 2012.

¹¹ ADGJSH, f. 19.

